ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër MINISTRIA E INFRASTRUKTURES

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**205-24-3280-5-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: "Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugës Rajonale R113, (PJESA ZHUR - DRAGASH) ".

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Traffiks VA SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga Radovan Zogoviq, B1, C3, Hyrja 2, nr.27
(Adresa)

Prishtinë — ***10 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/191919
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Visar Muriqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@traffiks-ks.com
(Adresa elektronike)

27.06.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. **Njoftimi për kontrate i datës 16.04.2024**
2. **Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara:**

   06.05.2024
3. **Dorëzimi i tenderëve: 13.05.2024**
4. **Njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 11.06.2024**
5. **Kërkesa për rishqyrtim dt.18.06.2024**
6. **Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt.21.06.2024**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi,
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.
Neni 64 Dështmitë e kërkesave
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së, B58 është ngritur në sistem me dt.11.06.2024, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik "SELECT PRIMA SH.P.K me çmim 102,518.40 €.

Neve na është dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Ne kemi pas qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe të ofertuesve tjerë dhe kemi vërejt se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm me arsyet që po i cekim më poshtë:

1. Tek **PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKT: është kërkuar-** Nr. 3 Pajisjet, operatori ekonomik duhet te këtë: 1 (një) rimorkio me elemente te sinjalizimit , (për paralajmërimin për punime ne rruge), kurse në FDT si dëshmi e kërkuar dokumentare për pajisjet është kërkuar si më poshtë:

Deshmia 5. Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD). Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit. Dëshmitë për pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listës se bashkangjitur ne Aneksin 1. Gjithashtu dëshmitë duhet te jene te dukshme.

OE i rekomanduar për kontratë në fjalë ka prezantuar vetëm një dokument për Shitblerjen e automjetit, ndërsa nuk ka ofruar Certifikatën mbi kontrollin teknik, Policen e sigurimit për pajisjen të cilën nuk regjistrohet, procesverbalin mbi kryerjen e kontrollit teknik te automjetit.

Nga kjo shihet qartas qe ky OE nuk posedon pajisjen siç është kërkuar në dosje të tenderit, andaj ky OE është dashur që të eliminohet dhe jo të shpallet fitues

2. Në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 2 Stafi i Kërkuar, operatori ekonomik në listën e stafit minimumi duhet te këtë 1.Menaxheri i Projektit-Inxhinier i diplomuar Drejtimi Komunikacion, Bachelor ose Master i komunikacionit, së paku pesë (5) vite përvojë pune pas diplomimit në lëmin e kërkuar.

Dëshmia 2 Dëshmia 1 CV e nenshkruar nga vete inxhinieri, diploma e noterizuar nga vete inxhinieri, kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar ne prezence te punëdhënësit dhe punëmarrësit), referencat për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar të lëshuara nga punëdhënësit.

- OE i rekomanduar për kontratë, për menaxher të projektit ka prezantuar, Ramadan Mazrekaj, ndërsa për këtë inxhinier ka prezantuar diplomën e cila nuk është e noterizuar ashtu siç është kërkuar, sepse nuk është e noterizuar në prezencë të Drejtorit të kompanisë Select Prima.

- OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar **z. Arber Jusufi** si gjeodet, ndërsa diploma nuk është e noterizuar nga vetë inxhinieri ashtu siç është kërkuar, por është e noterizuar nga një person me emrin Driola Gojani, prandaj nuk është përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit.

  Gjithashtu në kontratën për këtë projekt, nuk shkruhet kohëzgjatja e kontratës dhe nuk ka pagë te specifikuar, ndërsa sipas ligjit për marrëdhënie të detyrimeve paga është kusht esencial dhe kryesor i kontratës, prandaj kjo kontratë është e pavlefshme.

- OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar **z. Din Maloku** inxhinier të komunikacionit, ndërsa kontrata e punës nuk është e noterizuar në prezencë të të dy palave, por është e noterizuar nga njëri prej pronareve të kompanisë, prandaj nuk është përmbushur kërkesa e dosjes së tenderit.

  Gjithashtu në kontratën për këtë projekt, nuk shkruhet kohëzgjatja e kontratës dhe nuk ka pagë te specifikuar, ndërsa sipas ligjit për marrëdhënie të detyrimeve paga është kusht esencial dhe kryesor i kontratës, prandaj kjo kontratë është e pavlefshme.

3. Tek **PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM PËR PROJEKT** është kërkuar .9 Pajisjet, operatori ekonomik duhet te këtë: 1. Pajisje për matjen e reflektivitetit te sinjalizimit horizontal dhe vertikal.

OE në fjalë ka prezantuar faturën dhe Dudin doganor për këto dy pajisje, ku ne dyshojmë ne vërtetësinë e këtyre pajisjeve qe i ka prezantuar. Gjithashtu mungojnë edhe fotot për këto pajisje.

Fatura dorëzohet nga:		Fatura dërgohet në:	
SHITESI:	**TSR SHPK**	**BLERËSI:**	**SELECT PRIMA SH.P.K.**
Adresa	Nakaradë, Rruga Fehmi Lladrovci, Nr. 99	Adresa	Prishtinë, Henry Dynan, A-6, III
Tel:	049 341 368	Tel:	045/300-849
Cel:		Cel:	
Fax:		Emaili:	
Emaili:	info@tsr-ks.com	NIPT:	810196643
NIPT:	810863820	Person Kontakti:	

FATURA NR : 1

Faqja : 1 / 1

Data e faturës:	Data e skadimit:	Agjenti i shitjes-shitesi:	Transportuesi:	Njesia organiz.:
10/05/2024	10/05/2024			ASETET

Nr	Kodi	Përshkrimi i produktit	Sasia	Njësia	Çm. me TVSH	Çm. pa TVSH	Zbritja %	TVSH	Çm. me TVSH e Zbri.	Vlera me TVSH
1	KOD000000006 8	Pajisje per maljen e Retroreflektivitetit te bojes ne Rruge- Marka ARD Zender	1	COPE	2,800.00	2,372 88	0 00	427 12	2,800.00	2,800.00
2	KOD000000006 7	Pajisje per Maljen e Retroreflektivitetit RL dhe QD e perdorur	1	COPE	3,600.00	3,050.85	0 00	549.15	3,600.00	3,600.00

Vlera pa TVSH:	5,423.73
Zbritja:	0.00
TVSH:	976,27
Shuma e faturës:	6,400.00 €
Pagesa e tanishme:	0.00 €
Mbetur për pagesë:	6,400.00 €

Shënime:

Faturoi: **Dërgoi:** **Pranoi:**

Name of Bank: Raiffeisen Bank Kosovo:
Adress of Bank: Prishtinë
Account No: 1501110003753972
IBAN - XKO51501110003753972
Swift: RBKOXKPR

Këto pajisje në faturë shënohet se janë blerë nga TSR SHPK, mirëpo nuk kanë transaksion që janë blerë këto pajisje. Për më tepër sqarojmë se edhe nga Kompania TSR SHPK janë prezantuar këtë pajisje në këtë tender, e cila është e papërgjegjshme për këtë arsye, sepse nëse janë shitur atëherë i njëjti nuk i ka këto pajisje.

Dyshojmë se këtu ka një marrëveshje ndërmjet këtyre dy kompanive për të kurdisur këtë tender, duke pasur parasysh edhe këto pajisje që janë prezantuar nga këto dy kompani dhe duke pasur parasysh çmimin ofertues të këtyre dy kompanive. Prandaj kërkojmë që të verifikohen këto dëshmi dhe normalisht duhet që të dy këto kompani duhet të shpallen të papërgjegjshme.

Pra edhe **OE TSR SHPK** është e papërgjegjshme dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca në mungesë të këtyre dëshmive e jo të shpallet e pasuksesshme.

Ne me dt.21.06.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku autoriteti kontraktues është arsyetuar se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo që nuk ka dhënë arsye konkrete për një refuzim të tillë.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, arsyetohet duke i përmendur devijimet e vogla, sipas nenit 59.4 të LPP-së, fakt ky që nënkupton qartë se vetë AK-ja po e pranon se oferta e OE të rekomanduar për kontrate ka lëshime dhe mangësi, mirëpo njëjta është mundur ti cilësojë si gabime të vogla, mangësitë e të njëjtit

Ne lidhje me këtë qështje ju sqarojmë se mangësitë e OE të rekomanduar për kontrate si noterizimet e diplomave jo nga vetë inxhinierët, kontrata jo të noterizuara në prezencë të dy palëve drejtorit dhe inxhinierëve edhe kontratat të cilat nuk janë përpiluar sipas ligjit për marrëdhënie të detyrimeve nuk janë dhe nuk mund të quhen devijime të vogla, por janë mangësi substanciale, sepse nuk janë përmbush kërkesat e kualifikueshmërisë/kriteret e përzgjedhjes, **sipas nenit 25.5 Kriteret e përzgjedhjes të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:**

c. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon.

Kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa kalon/nuk kalon, prandaj me këtë rast oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk kalon tutje për shkak te këtyre mangësive. Shumë operator ekonomik nuk ofertojnë kur nuk mund ta plotësojnë njërën nga kërkesat e dosjes së tenderit, prandaj shpallja fitues e OE të Select Prima SHPK, me këto mangësi të cilat i posedon në ofertën e tij, është favorizim direkt për këtë kompani.

Pra ne edhe një herë po e sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për shkak që nuk i ka plotësuar kërkesat e specifikuara dhe të qartësuara më lartë, mirëpo autoriteti kontraktues pasi që nuk ka mundur në asnjë mënyrë të vërtetoj të kundërtën e pretendimeve tona, ka dhënë një arsyetim të përgjithshëm duke i cilësuar si devijime të vogëla të njëjtat mangësi të OE të rekomanduar për kontratë. Kërkojmë nga ana e OSHP-së që ti analizoj në tërësi pretendimet tona ankimore dhe të nxjerr një vendim meriton në lidhje me ankesën tonë.

Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me pretendimet tona kundrejt OE të rekomanduar për kontratë dhe OE tjetër TSR SH.P.K. dhe me këtë veprim e njëjta duke mos e arsyetuar vendimin për refuzim, nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 108/A të LPP-së, paragrafi 9 ku specifikohet qartë *"1.Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim".*

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm, për më tepër ky vendim është favorizim i hapur drejt OE të rekomanduar për kontratë dhe diskriminim kundrejt kompanisë tonë, si OE i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse na ka diskriminuar neve duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht jemi OE me çmim më të lirë.
Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".*

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse është rekomanduar për kontratë OE i papërgjegjshëm.

AK-ja është dashur të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET** ankesa e OE **Traffiks VA SH.P.K.** si e bazuar,
II. **ANULOHET,** njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shpenzimet mbi angazhimin ne përgatitjen e ofertave, sigurimin e ofertës, shpenzimet për shërbime te avokatisë dhe fitimin e pritur.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*